



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

C-III-12-1596

Paditësi

NKP Gjakovë, të cilën e përfaqëson avokat nga Gjakova

Kundër

Të paditurat

- 1. HC**, Gjakovë (trashëgimtare juridike e NP Gjakovë)
- 2. Komuna**, të cilën e përfaqëson Avokati Publik Komunal

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), Kolegji i përbërë nga Gazmend Sylaj Gjyqtar kryesues, Diellza Hoxha dhe Manushe Karaqi Gjyqtare, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 28 gusht 2019, merr këtë:

AKTVENDIM

- 1. Dhoma e Posaçme nuk ka kompetencë për vendosje kundër të paditurave.**
- 2. Lënda i referohet Gjykatës Themelore në Gjakovë.**
- 3. Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Fillimisht me 22 nëntor 2001, paditësi parashtroj padi pranë Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë – GJEQP , kundër të paditurave NP, Gjakovë dhe HC, Gjakovë.

Me padi, paditësi kërkoj që të obligohen të paditurat në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale si ajo mbi ndërtimin e Tregut pronësi e paditëses, që të paditurat të sigurojnë dokumentacionin teknik projektues të Tregut në lolacionin “L” pronësi e paditëses si dhe që të paditurat ti sigurojnë materijalin ndërtimor për ndërtimin e varrezave dhe për përfundimisht kërkesën materijale në lartësi prej 2.000.000 (dy million) DM me kamatë ligjore.

Padisë i është bashkangjitur:

- Kopja e kontratës mbi bartjen e së drejtës së shfrytëzimit dhe disponimit mbi token ndërtimore të qytetit dhe përcaktimit të ndërsjellë të drejtave dhe detyrimeve, kontratë kjo e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës së parë.

Me parashtrësën e datës 21 janar 2002, paditësi ndryshoj padinë në kuptimin subjektiv ashtu që tani si të paditur precizoj, të paditurat, HC, Gjakovë (trashëgimtare juridike e NP) dhe Komunën .

Sipas shkresës së datës 21 mars 2002, GJEQP referon lëndën për vendosje pranë Gjykatës Komonale në Gjakovë – GJKGj (tani gjykata themelore).

GJKGJ, me aktvendimin C.nr. 926/2002 të datës 10 korrik 2012, e referon lëndën pranë DHGPSJ.

Lënda regjistrohet pranë DHPGJS me 21 shtator 2012.

Arsyetimi ligjor

Në këtë çështje pala paditëse sipas Ligjit mbi ndërmarrjet publike (ligji nr. 03/L-087 me ndryshime dhe plotësime) bën pjesë në grupin e ndërmarrjeve publike e cila në rastin konkret administrohet nga e paditura e dytë, Komuna (lista 2 e ligjit).

Lidhur me të paditurën 1, HC, Gjakovë (trashëgimtare juridike e NP Gjakovë), bazuar në urdhërin e KS, Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP) me parashtrësën e saj të 25 korrik 2019, pohoj se e paditura nuk është nën admistrimin e saj.

Për më tepër sa i përket juridiksionit të DHPGJS-së, kjo rregullohet me nenin 5 të LDHP-së, dhe neni 6 i LDHP-së, i cili përcakton se kush mund të jetë paditës, respektivisht i paditur në procedurat para DHPGJS-së.

I/të paditur sipas nenit 6, nën-paragrafi 2.2 të LDHP-së sipas zgjedhjes së Agjencisë është Ndërmarrja, e cila është nën administrimin e Agjencisë apo Agjencia e cila vepron në emër të ndërmarrjes në fjalë.

Prandaj, DHPGJS duke u bazuar ne parimet ligjore sipas dispozitës së përmendur nuk ka jurisdikcion.

Megjithatë, në bazë të nenit 6.2, alinea 2.5, të LDHP-së i paditur në procedurat para DHPGJS-së është, “*në kuptim të cilësdo lëndë apo çështje para saj*”, mund të jetët çdo person që DHPGJS-ja e konsideron të nevojshëm apo të përshtatshëm për ta emëruar apo pranuar si të paditur në mënyrë që të sigurojë “*gjykimin e plotë dhe të tërësishëm*” të asaj lënde apo çështjeje.

Nga të gjitha arsyet e cekura si më lartë po ashtu sipas dispozitës së sipërpërmendur të Ligjit mbi DHPGJS, është e qartë se të paditurat, mund të shtohen si i paditur në lëndë, vetëm nëse tanimë ekziston një lëndë e cila është në pritje për t'u zgjidhur pranë DHPGJS-së, një (apo më shumë) të paditurit që bien nën përkufizimin e dhënë në nenin 6.2 të LDHP-së. Në të kundërtën, DHPGJS nuk ka juridiksion mbi një çështje nëse ndërmarrjet respektivisht komunat janë palë e vetme në një lëndë.

Prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Shpenzimet gjyqësore

Pasi që çështja i është referuar Gjykatës Themelore, në këtë fazë nuk caktohen shpenzime gjyqësore për palët në këtë çështje.

Këshilla ligjore

Në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS, apeli kundër këtij aktvendimi parashtrohet me shkrim për Kolegjin e Apelit të DHPGJS në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktvendimi. Afati i përcaktuar kohor fillon në mesnatën e ditës, kur pala përkatëse ka marrë vendimin me shkrim. Ankesa së bashku me Aktvendimin e ankimuar duhet gjithashtu të dorëzohet tek palët tjera nga Ankuesi, brenda të njëjtit afat kohor.

Në pajtim me nenin 9 paragrafi 8 i Ligjit për DHPGJS, në rast se pala parashtron ankesën, pala tjetër e procedurës mund të dorëzojë përgjigje prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, që nga data e dorëzimit të apelit tek ajo, duke parashtruar përgjigjen tek ankuesi dhe palëve tjera (nëse ka),

Siç përcaktohet në nenin 68 paragrafi 1.2, lidhur me nenin 38.3 të Ligjit për DHPGJS, parashtruesi i ankesës ka shtatë (7) ditë afat, pas dorëzimit të përgjigjejes ndaj ankesës së tij, të parashtrorë përgjigjen e tij ndaj asaj përgjigjeje tek Kolegji i Apelit dhe ta dorëzojë atë tek pala tjetër.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar kryesues

Diellza Hoxha, Gjyqtare

Manushe Karaqi, Gjyqtare
